



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:224620

Datë: 03.06.2022

Numri i dokumentit: 03094879

**K. Nr.1010 /21**

**Gjykata Themelore Gjilan,- Divizioni i Kundërvajtjes**, Gjyqtari Menderes Behluli, duke vendosur në lëndën kundërvajtëse kundër të pandehurit R.A nga....., për shkak të veprës kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 53 par 1, lidhur me nenin 255 paragrafi 2, të LRRTRR nr 05/L-088, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 87, 119 dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën **03.06.2022**, shpallë këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Kundër të pandehurit R.A nga babai....., i lindur me....., nga Kamenica me punë të perhershme në DPT Fatlumi K. Kamenicë, ku edhe tani jeton, i martuar, babai i gjashtë fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse me datën **21.09.2021** rreth orës **10:00 min**, i lartëshënuari ka shkaktuar aksident trafiku në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës **“VW Pasat“**, me targa ....., por qe kishte tabela provuse të Repoblikes së Kosovës të **RKS 134-TP-142**, dhe ishte duke lëvizur në rrugën **“Ibrahim Rugova“** në Gjilan, nga drejtimi i samaforve në drejtim të rrethërrotullimit me të arritur në vendëkalimin e këmbësorve për ballë hotel **“KRISTALI“**, duke mos mbajtur distancën e mjaftushme në mes të atuomjetve me pjesën e përparme të automjetit të tij, ndeshet në pjesen e pasme më vëturen **“MERCEDES“** me traga .....të cilin po e drejtonte Jeton Hasani, i cili në momentin kritik ishte i ndalur për shkak të kolones.

- Si pasojë e këtyre veprimëve shkaktohet aksident trafiku, më dëme materiale ku ndihmë mjekësore kërkojnë drejtusi i vetures **“Mercedes“** dhe pasagjerja e tij, si dhe lëndimie pëson pasagjerja e vetures **“Pasat“**, të cilet pas trajtimit mjeksor lirohen në shtëpi.

- Me ç'veprim ka kryer veprën kundërvajtëse të paraparë dhe të sanksionuar me dispozitat e nenit **53 par 1**, lidhur me nenin **255 paragrafi 2**, të **LRRTRR nr 05/L-088**, të Kuvendit të Kosovës, andaj

## **D Ë N O H E T**

**ME DËNIM GJOBË** në shumë prej **120 (njëqindnjëzetë) euro**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë sipas nenit 163 par.4 Të LK-së.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore t'i paguaj kësaj Gjykate shumë prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil Nga një kopje e aktgjykimit i'u dorëzohet palëve në procedurë .

## **A r s y e t i m**

**Trafiku Rajonal - Gjilan** ka parashtruar kërkesën me nr. **2021-CR-748** me datën **21.09.2021** për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartshënuar për veprën kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjyqtari me qëllim të vertetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ftoi te më datën **23.03.2022**, dhe mori në pyetje të pandehurin, i cili në deklarimin e tij të dhënë në Gjykatë, pohoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, duke deklaruar se vërtetë më datën **21.09.2021** rreth orës **10:00 min**, ne rrugen ".....", për ballë hotelit "**Kristal**" ne Gjilan, është involvuar në aksident komunikacioni, pa qëllim, pa dashje, edhe përkundër kujdesit gjatë vozitjës, se i ka ndodhur ky veprim, dhe për këtë kërkon ndjesë, kërkon falje, është hera e parë që i ka ndodhur nje veprim i tille, hera e parë që ballafaqohet me ligjin, meqë është i pa punë, mbajtës familjar, me kushte te veshtira materiale, lut gjykatën në këtë rast të merr parasysh këto rrethana si lehtësuese dhe ti shqiptoj dënim sa më të vogël- minimal.

Gjyqtari pas shiqimit të shkresave të lëndës, fotove te vendit te aksidentit, raportit mjekesor, si dhe deklaratës së të pandehurit, erdhi në përfundim të plotë, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elemente dhe prova të mjaftueshme, se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse e cila i vëhet në barrë, vepër kjo e paraparë dhe e sanksionuar me dispozitat e nenit **53 par 1**, lidhur me **255 paragrafi 2**, të **LRRTRR nr 05/L-088**.

Gjatë matjes së dënimit, gjyqtari pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat objektive dhe subjektive në të cilën është kryer kundërvajtja,

rrezikshmërinë shoqërore dhe tiparet personale të të pandehurit, pendimin, kërkim faljen, kështu që në vështrim të **nenit 31 p.1 të LMK-së**, mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe të pandehurit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, duke konsideruar se edhe me një lloj të tillë të dënimit do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të përsërisë kundërvajtje të tilla.

I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet për ekspertizë mjeko-ligjore dhe shpenzimet gjyqësore së bashku me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore është marrë në bazë të nenit 59 par 1, të LMK-së. Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjthëshëm**  
**Divizioni i Kundërvajtjes**  
**Me datën: 03.06.2022**

**Praktikantja,**  
**Vjollca Shabani**

**Gjyqtari**  
**Menderes Behluli**

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit aktgjykimi dhe atë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.